



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS**  
**REKTORI**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV/PROTOKOLLIT**

Tiranë, më 10.11. 2025

Lënda : Njoftim për shpallje konkursi për 2(dy) pozicione pune në Institutin e Kërkimit Shkencor të Sportit.

**DREJTORISË SË ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE DHE DIXHITALIZIMIT TË SHËRBIMEVE AKADEMIKO-SHKENCORE**

**KËTU**

Universiteti i Sporteve të Tiranës, bazuar në Ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e UST-së, si dhe në vendimin e Rektorit të UST-së, shpall kriteret për 2(dy) pozicione pune në Institutin e Kërkimit Shkencor të Sportit, për 1 (një) vend pune për personel akademik me kohë të plotë “Lektor”, pranë Departamentit të Performancës Sportive, dhe për 1 (një) vend pune për personel akademik me kohë të plotë “Asistent Lektor”, pranë Departamentit të Projekteve dhe Teknologjisë.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme për pozicionin e punës si “**Lektor**” me kohë të plotë në Departamentin e Performancës Sportive, në fushën e kërkimit “Performanca sportive dhe përgatitja fizike”, si më poshtë;

**I. KRITERE TË PËRGJITHSHME**

I	<b>KRITERE ELIMINUESE</b>
1	Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
2	Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurron;
3	Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
4	Të mos ketë prishur imazhin e UST-së;
5	Të mbajë të paktën gradën shkencore “Doktor”. (Grada shkencore e mbrojtur në institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
6	Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës

*Shënim: Në rast mosplotësimi të kriterëve më sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.*

## II. Kriteria Specifike

1. Të ketë gradën shkencore “Doktor” në Fushën e Shkencave Sportive.
2. Të ketë tregues në specializimin e përgatitjes fizike dhe analizën e garës.
3. Të ketë përvojë në mësimdhënien e lëndëve përkatëse ose specializim në fushën e kërkuar.
4. Të ketë përvojë kërkimore në fushë.

## III. Kriteria preferenciale:

1. Të ketë përvojë pune me kohë të plotë ose të pjesshme në arsimin e lartë, ose pranë institucioneve sportive kombëtare sipas fushës.
2. Të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtor në UST.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme për pozicionin e punës si **“Asistent Lektor”** me kohë të plotë në Departamentin e Projekteve dhe Teknologjisë, si më poshtë;

## IV. KRITERE TE PËRGJITHSHME

I	KRITERE ELIMINUESE
1	Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
2	Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurren;
3	Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
4	Të mos ketë prishur imazhin e UST-së;
5	Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës. Ai duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, Master i shkencave ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njëzuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
6	Të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të mbi 8. Nqse njëri nga kandidatët ka mbaruar specializime afatgjata do të ekuivalentohet nota mestare me studimet Bachelor, Master i Shkencave dhe Specializime afatgjata.
7	Të ketë notë mesatare mbi 8-të në studimet e nivelit “Bachelor”, DIND, Master Shkencor dhe Specializime afatgjata, si dhe specialiteti i lëndës që konkuron duhet të jetë mbi 8. Per çdo 0.1 note më shumë se 8.00, shtohet me 0.5 pike në vlerësim, gjithsej 10 pikë
8	Të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).

*Shënim: Në rast mosplotësimi të kriterëve më sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.*

## V. Kriteria Specifike

1. Të ketë përfunduar studimet Master Shkencor ose DIND (Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë) në fushën e inxhinierisë mekatronike.
2. Të ketë mesatare të përgjithshme mbi 8 (tetë).
3. Nota e lëndës së specialitetit të jetë mbi 8 (tetë)
4. Të ketë kryer specializime dhe trajnime në fushën për të cilën është diplomuar .

## **VI. Kriteria preferenciale:**

1. Të ketë marrë pjesë në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare
2. Të ketë punime kërkimore të dokumentuar në laboratorë të ngjashëm.
3. Të kenë eksperiencë në aktivitete profesionale kombëtare, si trajnime, seminare dhe workshop-e në fushën e tij/të saj të ekspertizës.

### ➤ **Vlerësimi i Intervistës:**

- Në aftësitë shprehëse për mënyrën e paraqitjes së filozofisë së mësimdhënies nga ana e kandidatit.
- Prezantimin në ppt dhe referimin e një teme që lidhet me fushën, specialitetin, lëndën që ai pretendon të mbulojë (mini – leksion).
- Të jetë i gatshëm t'i përgjigjet pyetjeve të ndryshme rreth fushës së studimit.
- Kandidati duhet të jetë i përgatitur që mund të intervistohet edhe në gjuhën të cilën ai ka të certifikuar në aplikim.
- Vlerësimi i Kandidatit në Total është me 100 pikë, 70 pikë nga dosja dhe 30 pikë nga intervista.
- Në rast se një nga kandidatët nuk ka marrë të paktën 50 pikë (50% të pikëve totale) komisioni vendos përfundimin e proçedurës së këtij kandidati pa u përzgjedhur.
- Në rast se kandidatët janë me pikë të barabarta, atëherë renditja bëhet nëpërmjet shortit.

## **VII. Kandidatët që do të aplikojnë për këto vënde pune duhet të dorëzojnë këto dokumenta:**

- a) Mbushja e aplikimit (formulari tip) dhe firmosja e tij në çdo faqe, të cilën e shkarkoni nga Web-siti i UST-së.
- b) Shprehje e interesit nga ana e kandidatit me shkrim për plotësimin e vendit vakant duke shprehur në të edhe vizionin e tij për këtë pozicion.
- c) Biografi e punës mundësisht me eksperiencat që lidhen me vendin e punës për të cilin aplikon kandidati.
- d) Kopje e noterizuar e diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njëhsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
- e) Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm origjinal ose të noterizuar, sipas plotësimit të kriterëve të shpallura.
- f) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) ose formulari i vetëdeklarimit.
- g) Letra rekomandimi nga profesorë të fushës.
- h) Fotokopje të dëshmive të kualifikimeve të ndryshme, të noterizuara.
- i) Listë të punimeve shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare profesionale/shkencore dhe/ose punime të tjera, pjesëmarrje në referime shkencore, në konferenca etj; ( mundësisht linku i artikullit ose conferences. ISBN ose ISSN të artikujve ose botimeve).

## **VIII. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit.**

Dokumentacioni i plotësuar sipas kriterëve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik, bëhet on-line në faqen e UST-së ose me postë sipas afateve të shpallura:

- Në rastin e aplikimit online në faqen zyrtare të UST-së, kandidati është i detyruar që të dorëzojë edhe fizikisht dosjen e tij të aplikimit ditën që do të ftohet për intervistë nëse kalon fazën e parë të aplikimit.
- Kandidati nuk mund të paraqesë asnjë dokument tjetër shtesë përveç atyre që ka aplikuar on-line në web-site të UST-së.
- Dokumentacioni i dorëzuar me anë të shërbimit postar dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të këtyre kandidatëve.

#### **VI . Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët .**

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 10 (dhjetë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit në faqen e UST-së dhe APP.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit dhe departamenti, specialiteti ku aplikon, emri mbiemri.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV/PROTOKOLLIT**